



Home > Aktualitet > I dënuar me 6 vite burg dhe lëvizte me armë me vete, arrestohet 30-vjeçari në V...

AKTUALITET

I dënuar me 6 vite burg dhe lëvizte me armë me vete, arrestohet 30-vjeçari në Vorë

Në prangat e policisë ka rënë një 30-vjeçar me initiale E.H pasi lëvizte me armë me vete. Ai rezultoi i dënuar edhe me 6 vite burg për "Trafikim i narkotikëve" dhe "Plagosje e rëndë me dashje".



Foto ilustruese

11 Qershor, 2019 12:50

Tiranë- Në prangat e policisë ka rënë një 30-vjeçar pasi rezultoi i dënuar me 6 vite burg për trafik droge dhe plagosje me dashje. Sipas policisë E.H 30-vjeçar lëvizte me armë me vete dhe nga policia është sekuestruar një armë zjarri tip pistoletë.

Njoftimi i policisë:

Vorë, Tiranë

Finalizohet operacioni i koduar "Mesnata", në fushën e armëmbajtjes pa leje.

Qarkullonte me armë zjarri, vihet në pranga 30 vjeçari, me precedent penal në fushën e narkotikëve dhe krimeve ndaj personit.

Operacioni nga Komisariati i Policisë Vorë.

Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale një armë zjarri Pistoletë dhe një krëhër me 7 fishekë.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Shërbimet e komisarit Vorë në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë, si dhe bazuar në informacionet e marra në rrugë operative se një shtetas me precedent penal të mëparshëm qarkullonte me armë zjarri me vete, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin e koduar “Mesnata”.

Si rezultat i operacionit në rrugën dytësore në hyrje të Vorës u bë e mundur kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit:

E. H., 30 vjeç, banues në Vorë, i dënuar më parë me 6 vite burg, ekstraduar nga Kroacia për veprën penale “Trafikim i narkotikëve” si dhe proceduar për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”.

Gjatë kontrollit të ushtuar në automjetin tip Audi, në çantën e dorës së këtij shtetasi, Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një armë zjarri Pistoletë me një krëhër me 7 fishekë, që e mbante pa leje.

Materialet i kaluan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municionit luftarak”.

J.V/Dosja.al



ETIKETA: [#arrestohet 30-vjeçari në vorë](#) [#i riu lëvizte me arme](#)

6

SHARES



Previous article

Bëhuni gati për verën, Netflix liston 10 filmat e preferuar të sezonit (Foto)

Next article

DEL VIDEO/ Ahengu i Vangjush Dakos me Astrit Avdylin në Durrës, verë e ushqim luksi për fitoren në zgjedhje

Shto Koment